



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1000 Regj
Nr.811 Prot

Tiranë, më 25.02.2020

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar : Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa : Tirane
Per dijeni : Shoqeria “RESORT LUXURY” Shpk me NIPT L81723022D
Adresa : Korce, Lagja Nr. 7, Rruga 6 Deshmoret, Nr. 14
Per dijeni : Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes se Tregut
Adresa : Blv “Deshmoret e Kombit”, Tiranë

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.1857, datë 21.10.2019 nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1000, Datë 15.11.2019 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes se Tregut ndaj debitorit Shoqeria “RESORT LUXURY” Shpk me NIPT L81723022D, në lidhje me titullin ekzekutiv Vendimi perfundimtar Nr.1604/2, datë 05.07.2019 nga Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes se Tregut.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 3064 Prot, Datë 10.07.2019, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.1857, datë 21.10.2019 nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori Shoqeria “RESORT LUXURY” Shpk me NIPT L81723022D, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit Shoqeria “RESORT LUXURY” Shpk me NIPT L81723022D në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijueste K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore Shoqeria “RESORT LUXURY” Shpk me NIPT L81723022D, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe moskryerjen e çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregtar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijani.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”
PËRMBARUESI GJYQËSOR
RESUL ALUSHANI

